



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 7210 Prot.

Tiranë, më 15.11.2019

Lënda: Propozim për miratimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, të ndryshuar, dhe efektit financiar të tij në projektbuxhetin e shtetit për vitin 2020.

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në vëmendje të:

Z. GRAMOZ RUÇI, KRYETAR I KUVENDIT ✓
Z. ULSI MANJA, KRYETAR I KOMISIONIT TË LIGJEVE

Për dijeni:

MINISTRISË SË FINANCEVE DHE EKONOMISË
ZNJ. ANILA DENAJ, MINISTËR

Të nderuar,

Propozimi i Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, “Për disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, të ndryshuar”, i përcillet Kuvendit të Shqipërisë si organi kompetent në bazë të nenit 78 dhe C të Kushtetutës, si dhe të nenit 18, pika 1 dhe nenit 19, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Pas 2 vitesh punë intensive dhe angazhim maksimal të anëtarëve të Komisionit, këshilltarëve të njësisë së shërbimit ligjor dhe stafit mbështetës të tij, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë kontributin e tij më të rëndësishëm në avancimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve të ligjit nr. 84/2016, duke i hapur kështu rrugën ngritjes së institucioneve të reja të këtij sistemi dhe Reformës në Drejtësi.

Në kuadër të plotësimit të kriterëve që Bashkimi Evropian i ka vendosur shtetit shqiptar dhe institucioneve përgjegjëse, për integrimin dhe anëtarësim në BE, për përfundimin e reformës në drejtësi dhe ngritjen e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit i ka drejtuar rekomandim me shkrim Komisionit, për përfundimin e procesit të rivlerësimit brenda mandatit 5-vjeçar të përcaktuar nga Kushtetuta. Për këtë qëllim ONM-ja kërkon që Komisioni të adresojë me prioritet maksimal në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kërkesën zyrtare për mbështetje me buxhete dhe organikë shtesë me 12 këshilltarë juristë në njësinë e shërbimit ligjor të KPK-së, duke e rritur numrin e përgjithshëm të njësisë së shërbimit ligjor nga 24, në 36 këshilltarë gjithsej (24 këshilltarë juristë dhe 12 këshilltarë ekonomikë).

Mbështetja me fonde buxhetore të mjaftueshme për forcimin dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore të Komisionit dhe rekomandimi i ONM-së për shtim organike dhe mbështetje financiare, janë argumente të rinj, të cilat u shtohen atyre të përsëritur në kërkesat tona zyrtare.

Theksojmë se Komisioni ka dhe vijon të ketë ngarkesën më të madhe të procesit të rivlerësimit, dhe për këtë flasin vetë rezultatet cilësore dhe ato sasore në rritje të numrit të çështjeve dhe subjekteve të rivlerësuar, në krahasim me institucionet e tjera të rivlerësimit.

Për këtë arsye, ONM-ja rekomandon në këtë fazë, që Komisioni të mbështetet dhe të përmbushë misionin që i ka caktuar Kushtetuta dhe ligji nr.84/2016, kur ka mbetur edhe 2 vjet e gjysmë nga mbarimi i mandatit të tij.

Komisioni, që nga fillimi i funksionimit si institucion rivlerësimi, ka mbajtur jo vetëm peshën kryesore të këtij procesi, por ka ndërtuar praktikën e parë administrativo-gjyqësore, duke përballuar ngarkesë pune tej normales, presion afatesh dhe jo vetëm, përballje me vështirësi të ndryshme për shkak të natyrës së veçantë të punës, që buron dhe është organikisht i lidhur me statusin e veçantë ligjor të Komisionit. Komisioni ka një status të veçantë si institucion rivlerësimi, për shkak edhe të vetë statusit që gëzojnë anëtarët e tij në bazë të Kushtetutës, duke u barazuar me anëtarin e Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, Komisioni si institucion i pavarur kushtetues, në kuptim të jurisprudencës, bën gjykimin fillestar të subjekteve të ligjit nr. 84/2016 dhe, nga kjo pikëpamje, është specifikisht i pakrahasueshëm me asnjë nga institucionet e tjera të administratës publike apo me procedura administrative të njohura dhe aplikuar deri më tani.

Komisionerët dhe stafi i KPK-së, punojnë tej çdo norme të lejuar dhe mbi limitet e caktuara të orëve të punës (mesatarisht 12-14 orë në ditë, në çdo ditë të javës, përfshirë fundjavën dhe ditët e pushimit të festave zyrtare). Dokumentacioni që administrohet dhe prodhohet, kalon përmes disa fazave: procesohet, studiohet, përpunohet dhe deri në dhënien e vendimit, angazhon të gjitha strukturat e njësisë organizative të Komisionit. Për këtë arsye, procesi i rivlerësimit dhe rëndësia e tij na kushtëzojnë për të adresuar zyrtarisht kërkesat për buxhete, për paga dhe përfitimet financiare të Komisionerëve dhe stafit të Komisionit.

Gjatë viteve 2017-2019, Komisioni me shkresat nr. 4684 prot., datë 12.06.2018; nr. 6485, datë 12.06.2018; nr. 4938 prot., datë 26.06.2018; nr. 6252 dhe 6253 prot., datë 20.09.2018, i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë dhe institucioneve përgjegjëse për mbështetje financiare, për shtesë organike dhe shtesë page për natyrë të veçantë pune dhe shkallë vështirësie. Në përgjigje të kërkesave tona, janë kthyer dy përgjigje gjithsej: një përgjigje e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, regjistruar me tonën nr. 4684/2 prot., datë 11.7.2018, si dhe një përgjigje e Ministrisë së Drejtësisë, regjistruar me tonën nr. 4938/1 prot., datë 7.08.2018 (bashkëlidhur kopje e tyre).

Ndryshimet e propozuara dhe efekti financiar:

- Shtesa me 12 këshilltarë dhe ndryshimet e propozuara, të pasqyrohen në paragrafin I dhe II të projektvendimit, si dhe respektivisht në Lidhjen 1 dhe 2, që janë pjesë integrale e tij. Pra, nga 24 këshilltarë gjithsej, në 36, duke u bërë 12 këshilltarë ekonomikë dhe 24 këshilltarë ligjorë.
- Në tekstin e projektvendimit, pas paragrafit II, shtohet paragrafi III, me këtë përmbajtje: *“Anëtari i Komisionit, përfiton pagesën për vështirësi në masën 200% të pagës mujore G3.”*
- Pas paragrafit III, shtohet paragrafi IV, me këtë përmbajtje: *“Këshilltari ligjor dhe ekonomik i Komisionit përfiton pagesë shtesë për shkak të vështirësisë deri 3 paga në vit.”*
- Pas paragrafit IV, shtohet paragrafi V, me këtë përmbajtje: *“Të gjitha pozicionet e punës të stafit administrativ, njësitë organizative IV,V dhe VI, të lidhjes I, përfshirë dhe pozicionin e Sekretares së Kryetarit të Komisionit një njësinë organizative I, bashkëlidhur këtij vendimi, përfitojnë për natyrë të veçantë pune dhe shkallë vështirësie, pagesë shtesë prej 20,000 lekë në muaj.”*
- Pas paragrafit V, shtohet paragrafi VI, me këtë përmbajtje: *“Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet financiare i fillojnë nga data 1 janari i vitit 2020.”*

Efekti financiar dhe parashikimi i tij në projektligjin “Për miratimin e Buxhetit të Shetit për vitin 2020.

Sa i takon efektit financiar të këtij projektvendimi, për 12 këshilltarët ligjorë shtesë, gjatë një viti buxhetor, duhen për zërin “Paga”, Art. 600, “Sigurime shoqërore”, Art. 601, afërsisht **35.2 milion lekë në vit.**

Kësaj vlere i shtohet edhe përlllogaritja e zërit “Shpenzimeve operative dhe mirëmbajtje”, Art. 602, për 12 këshilltarët ligjorë shtesë, në shumën **5 milion lekë.** Gjithashtu për sistemin e tyre vend pune/për këshilltar, kërkon fonde shtesë në Art. 231, zëri “Investime”, afërsisht në shumën **2 milion lekë,** për vitin 2020.

Për arsye të pagesës shtesë për shkak të vështirësisë, sipas rastit, parashikuar në nenin 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, për 12 këshilltarët shtesë të njësisë së shërbimit ligjor, llogaritur deri në 3 paga mujore, ky efekt shtesë shkon **8 milion lekë,** në vit.

Pagesa shtesë për shkak të vështirësisë për 24 këshilltarët aktualë të njësisë së shërbimit ligjor, llogaritur deri në 3 paga mujore, ky efekt financiar shtesë për ta shkon **16 milion lekë, në vit.**

Gjithsej, efekti financiar për pagesën shtesë për shkak të vështirësisë, parashikuar në nenin 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, *për 36 këshilltarët të njësisë së shërbimit ligjor*, llogaritur deri në 3 paga mujore, plus edhe efektin e sigurimeve shoqërore shtesë, mund të arrijë vlerën **25 milion lekë, në vit.**

Për sa më sipër, në total përgjatë një viti buxhetor, efekti financiar për njësinë e shërbimit ligjor, është afërsisht **67 milion lekë, në vit.**

Nëse llogaritim pagesë shtesë për vështirësi për personelin administrativ në masën **20,000 lekë/person**, fondi i nevojshëm për të përballuar këtë shtesë page, do të ishte afërsisht **7.3 milion lekë, në vit.**

Në total, efekti financiar për përballimin e shtesës në organikë me 12 këshilltarë të njësisë së shërbimit ligjor, plus shtesës për pagesë të vështirësisë për 36 këshilltarë të njësisë së shërbimit ligjor, si dhe shtesën prej 20 mijë lekë për stafin administrativ, arrin vlerën afërsisht **75 milion lekë.**

Duke llogaritur edhe shtesën për pagesë vështirësie për Komisionerët, në masën 200 % të vlerës së pagës mujore, atëherë vetëm për këtë rritje kërkohet edhe një fond shtesë në shumën 53 milion lekë.

Totali i këtyre shtesave dhe ndryshimeve ka një efekt financiar në Buxhetin e Shtetit afërsisht 128 milion lekë, për vitin 2020.

Sa më sipër, dhe bazuar në rekomandimet e ONM-së, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kërkon me prioritet:

- Miratimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, të ndryshuar.
- Miratimin e efektit financiar dhe përfshirjen e shtesës në buxhetin për KPK-në, në projektligjin “Për miratimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2020”, si rrjedhojë e miratimit të këtij projektvendimi.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI
Genta Tafa (Bungo)

